



## VENDIMI I PESTË MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT PËR SHQYRTIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

**Data e vendimit: 18 gusht 2022**

**Lënda nr. 2011-20**

**X dhe 115 ankues të tjerë**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) i mbledhur më 18 gusht 2022, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Snježana BOKULIĆ, ushtruese e detyrës së kryesueses së Panelit  
Z. Alexander FASSIHI, anëtar

Ndihmuar nga:

Z. Ronald Hooghiemstra, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 11 dhjetor 2019,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. HISTORIKU I PËRGJITHSHËM I LËNDËS DHE I VENDIMIT TË PANELIT TË DATËS 22 PRILL 2015**

1. Në këtë lëndë përfshihen shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Si historik, kjo lëndë ka të bëjë me keqtrajtimin dhe shkeljen e të drejtave themelore të 115 parashtruesve të ankesave të përkatësisë etnike rome nga veprimet dhe mosveprimet që i atribuohen autoriteteve të ndryshme.
2. Për shkak të kufizimeve në juridiksionin e tij, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejme: "Paneli") kishte kompetencë për t'u marrë vetëm me shkeljet e të drejtave që i atribuohen Misionit të EULEX-it Kosovë (në tekstin e mëtejme: Misioni) gjatë mandatit të tij ekzekutiv.
3. Me vendimin e datës 22 prill 2015, Paneli ka vendosur që Misioni ishte përgjegjës për shkeljen e të drejtave të këtyre individëve për një zgjidhje efektive juridike, të garantuar, *ndër të tjera*, me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa) që i atribuohet Misioni në këtë rast. Veçanërisht problematike ishte mos kryerja nga ana e

Misionit e një hetimi efektiv të rrethanave në të cilat të drejtat themelore të viktimave ishin shkelur nga autoritete të tjera.

4. Paneli në përputhje me rrethanat i ka bërë këto rekomandime shifes së Misionit (ShM-së) sipas rregullës 34 të rregullores së punës:

“Që ShM-ja t’i udhëzojë zyrtarët kompetent të EULEX-it që të kërkojnë prej autoriteteve të Kosovës nëse është duke u zhvilluar ndonjë hetim për këtë çështje dhe nëse po, në cilën fazë të procesit tani qëndron çështja. ShM-ja duhet të informojë Panelin për rezultatin e kësaj kërkesë.

Pas marrjes së këtij informacion, ShM-ja duhet t’i udhëzojë prokurorët e EULEX-it të shqyrtojnë nëse do të marrin ose jo përgjegjësinë për këtë rast në pajtim me nenin 7(A) të Ligjit nr. 04/L-273 mbi Juridiksionin dhe Kompetencat e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it (Ligji mbi Juridiksionin), duke marrë parasysh rrethanat përkatëse, siç theksohet më lart, në veçanti nevojën që Misioni të garantojë mbrojtjen efektive të të drejtave të parashtruesit të ankesës. ShM-ja duhet të informojë Panelin për vendimin e prokurorit në lidhje me këtë”.

5. Paneli gjithashtu ka kërkuar nga ish ShM-ja t’i ofroj Panelit informatat e kërkuara më së voni deri me datën 15 qershor 2015.
6. Më 31 gusht 2015, ShM-ja ka informuar Paneli për disa masash të ndërmarra në lidhje me rekomandimet e Panelit. Në veçanti, ai i ka shkruar shefit të Divizionit Ekzekutiv të EULEX-it dhe u.d. të kryeprokurorit të EULEX-it duke kërkuar që të marrin në konsideratë vendimin e Panelit dhe duke kërkuar nga ata që të vlerësojnë nëse do të kishte mundësi të zbatohet neni 7A i Ligjit nr. 04/L-273 mbi Juridiksionin dhe Kompetencat e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it të ndryshuar (Ligji mbi Juridiksionin) në lëndën penale që është subjekt i vendimit të Panelit dhe që t’ia caktojë rastin ndonjë prokurori të EULEX-it për shkak të “rrethanave të jashtëzakonshme” në kuptim të kësaj dispozite.
7. Më 19 gusht 2015, u.d. i shefit të Misionit dhe u.d. i kryeprokurorit kanë njoftuar ShM-në se sipas nenit 7A, siç kërkohet nga neni 7A i Ligjit për juridiksionin dhe kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it të ndryshuar (Ligji nr. 04/L-273), ata kishin vlerësuar bashkërisht lëndën dhe kishin arritur në përfundimin se rrethanat e jashtëzakonshme nuk ishin përmbushur për të aktivizohet juridiksioni i prokurorëve të EULEX-it. Ata arritën në përfundimin se “rrethanat e jashtëzakonshme” të kërkuara nga neni 7A nuk ishin përmbushur dhe juridiksioni i prokurorëve të EULEX-it nuk mund të aktivizohej. Sidoqoftë, ushtruesi i detyrës së prokurorit të EULEX-it e siguroi ShM-në që nëse rrethanat e tilla shfaqen në të ardhmen lënda dhe zbatueshmëria e nenit 7A mund të rishqyrtohet.
8. Më tej u.d. i kryeprokurorit të EULEX-it ka parashtruar se në vendimin e tij mbi meritat e kësaj lënde, Paneli kishte kritikuar EULEX-in për fillimin e hetimit një ditë pas të ashtuquajturës “datë e afatit përfundimtar” e 14 prillit 2014. Ai ka argumentuar se deri më tani nuk kishte pasur asnjë vendim për të filluar hetimin, por lënda ka mbetur aktualisht në fazën paraprake hetimore me qëllim të përcaktimit nëse ishte kryer vepër penale apo jo, dhe nëse po, kush do të ishte i dyshuari për atë vepër penale. U.d. i kryeprokurorit të EULEX-it gjithashtu kishte parashtruar se përfaqësuesi i ankuesve nuk i ishte përgjigjur pyetjeve të dërguara nga prokurori vendor dhe informatat e ofruara nga ankuesit duket se kanë vlerë shumë të kufizuar dëshmuese.
9. Pavarësisht prej çfarë u përmend më sipër, prokurori vendor i caktuar në këtë lëndë ka dërguar raportin penal në Prokurorinë Speciale të Kosovës për të vlerësuar nëse do të binte ajo në kompetencë të tyre. Përgjigja ishte negative; sipas zëvendës kryeprokurorit

të Zyrës së Prokurorisë Speciale, nuk kishte asnjë indikacion për përfshirje të krimit të organizuar në këtë rast dhe kështu ajo ka dalë jashtë juridiksionit të tij. Rrjedhimisht lënda ka mbetur tek autoritetet e prokurorisë së Kosovës.

10. U.d. i kryeprokurorit të EULEX-it ka dhënë garanci se prokurori i EULEX-it i caktuar më parë në këtë lëndë do të ishte në dispozicion të prokurorit vendor në kapacitetin e tyre të mentorimit dhe këshillimit.
11. Më 13 shtator 2015, ankuesit kanë parashtruar përgjigjen e tyre lidhur me informacionin e dhënë nga ShM-ja. Ata nuk u pajtuan me parashtrimin e ShM-së se lënda ishte jashtë juridiksionit të EULEX-it. Ata gjithashtu pohuan se, në kundërshtim me pohimet e ShM-së, përfaqësuesit e tyre nuk ishin kontaktuar nga EULEX-i Kosovë.
12. Më pas, Paneli në lidhje me këtë rast ka lëshuar katër vendime pasuese.

## **II. VENDIMI I PARË PASUES**

13. Në një vendim pasues të datës 11 nëntor 2015, Paneli ka vënë në dukje hapat e ndërmarrë nga ShM-ja për zbatimin e rekomandimeve të Panelit, siç ishte theksuar në letrën e tij të datës 31 gusht 2015.
14. Paneli kanë thënë se ishte i bindur që ShM-ja ka zbatuar rekomandimin e tij për të kërkuar nga autoritetet vendore nëse hetimet ishin në proces e sipër ose jo. Në këtë kontekst është vërejtur se lënda së pari ishte sjellë në vëmendjen e autoriteteve të prokurorisë së Kosovës në nëntor 2013, pothuajse dy vjet më herët. Më tutje ishte theksuar se ShM-ja nuk kishte ofruar asnjë informatë lidhur me atë nëse ishte marrë apo jo ndonjë dëshmi gjatë hetimit apo nëse ndonjë dëshmitar ishte marrë në pyetje nga autoritetet ndjekëse të Kosovës. ShM-ja gjithashtu nuk kishte dhënë ndonjë informacion lidhur me afatin e mundshëm brenda të cilit mund të përfundohej lënda. E as nuk ishte vërtetuar se viktimat ishin përfshirë në mënyrë kuptimplote në procesin e hetimeve në vazhdim e sipër. Prandaj nuk ishte treguar për bindjen e Panelit se ka pasur progres të vërtetë në atë hetim. Në këto rrethana, e drejta e ankuesit për mjet efektiv juridik, në përputhje me nenin 13 të Konventës, ende konsiderohej se ishte në mënyrë negative e prekur nga mungesa e një përpjekjeje të dukshme për hetimin e menjëhershëm dhe efektiv të lëndës.
15. Për më tepër, Paneli ka vënë në dukje vendimin e kryeprokurorit të shtetit të Kosovës dhe kryeprokurorit të EULEX-it për të mos e caktuar lëndën tek ndonjë prokuror i EULEX-it. Paneli konsideron se efektshmëria e hetimit do të ishte përmirësuar në masë të madhe nëse do të ishin shfrytëzuar ekspertiza dhe burimet e kryeprokurorit të EULEX-it.
16. Rrjedhimisht, Paneli konsideron se hapat e ndërmarrë deri më tani nga EULEX-i nuk ishin të tilla që të sigurohej se e drejta themelore e ankuesit për një zgjidhje efektive po mbrohej në mënyrë efektive. Prandaj Paneli e ka ftuar Misionin të vazhdojë ndërlidhjen me autoritetet kompetente të Kosovës me synimin për të përcjellë progresin e hetimit. Paneli më tutje ka ftuar ShM-në që të sigurojë informata mbi mënyrën në të cilën nocioni i "rrethanave të jashtëzakonshme", sipas kuptimit të nenit 7A, si kriter vendimtar, të interpretohet në praktikë në lëndët që janë duke u marrë përsipër nga autoritetet ndjekëse të EULEX-it.
17. Paneli ka shpallur se ShM-ja kishte zbatuar rekomandimet e veta vetëm pjesërisht dhe se e drejta e ankuesit për një zgjidhje efektive ka vazhduar të ndikohej negativisht në mungesë të hetimit efektiv të lëndës.

18. Paneli ka ftuar ShM-në të ofroj sqarime të cilat i kishte kërkuar në lidhje me interpretimin nga EULEX-i Kosovë, të dispozitës së "rrethanave të jashtëzakonshme" të nenit 7A të Ligjit mbi Juridiksionin. Paneli gjithashtu ka ftuar EULEX-in Kosovë përmes ShM-së të kërkojë informacion të rregullt nga autoritetet e Kosovës në lidhje me ecurinë e hetimeve nga ana e tyre. Paneli po ashtu ka ftuar EULEX-in Kosovë, përmes ShM-së, të kërkojë informacion të rregullt nga autoritetet e Kosovës në lidhje me ecurinë e hetimeve jo më vonë se data 28 shkurt 2016 dhe të vazhdojë të merrej me çështjen.
19. ShM-ja i është përgjigjur Panelit më 2 mars 2016 në lidhje me rekomandimet e dhëna nga Paneli në vendimin e tij të datës 11 nëntor 2015. Sa i përket kërkesës dërguar ShM-së për dhënie të informatave rreth mënyrës së interpretimit në praktikë të nocionit "rrethana të jashtëzakonshme" në kuptim të nenit 7A si kriter vendimtar për rastet që merren në shqyrtim nga autoritetet e EULEX-it për ndjekje penale, ShM-ja ishte përgjigjur si vijon:
- Ishte dashur të kihej parasysh se zbatimi i nenit 7A ka kërkuar vendim të përbashkët nga kryeprokurori i shtetit të Kosovës dhe kryeprokurori i EULEX-it, andaj secili rast ishte vlerësuar bashkërisht.
20. ShM-ja ka thekuar se procedura për vlerësimin e pranisë së rrethanave të tilla ishte miratuar nga kryeprokurori i shtetit dhe ushtruesi i detyrës së kryeprokurorit të EULEX-it në tetor të vitit 2014. Në mënyrë specifike, ishte thënë se për çdo vlerësim të atillë të vlenin kriteret e paraqitura në vijim:
- Nëse ekspertiza dhe përvoja e prokurorëve të EULEX-it do të siguronin hetimin dhe ndjekjen penale të duhur të rastit;
  - Ekzistojnë dyshime të bazuara për tentime të ndikimit mbi hetimet apo ndjekjen penale;
  - Rasti nën hetime apo ndjekje penale prekë interesat e shteteve anëtare të BE-së apo përfshirjen e ndonjë pjesëtari të stafit të EULEX-it në Kosovë.
21. ShM-ja ka thekuar se nëse përmbushet një apo më shumë prej këtyre kriterëve, atëherë kryeprokurori apo zëvendës kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), apo kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, së bashku me prokurorin e EULEX-it do të paraqisnin propozim të arsyetuar të përbashkët tek kryeprokurori i shtetit të Kosovës dhe tek kryeprokurori i EULEX-it me qëllim që rasti t'i caktohet një prokurori të EULEX-it, qoftë vetëm ose së bashku, në një ekip të përzier, varësisht prej rrethanave të rastit.
22. Meqë në rastin në fjalë ka pasur përfshirje të prokurorëve të EULEX-it në një fazë të hershme, asnjë prej kriterëve të paraqitura më sipër nuk konsiderohej të ishte përmbushur. Rasti nuk kishte asnjë tipar që do të kërkonte ekspertizë speciale prokuroriale të prokurorëve të EULEX-it; nuk kishte tregues të përpjekjeve për ndërhyrje në hetime; prokurorët vendorë shprehën gatishmërinë dhe mundësinë për të punuar me rastin, andaj fillimisht ishte krijuar një ekip i përzierë. Për më tepër, rasti nuk dukej se i prekte interesat e shteteve anëtare të BE-së e as nuk ka pasur ndonjë përfshirje të ndonjë pjesëtari të stafit të EULEX-it në këtë rast.
23. ShM-ja po ashtu ka theksuar se rasti kishte qenë dhe ende vazhdonte të ishte në fazën fillestare të procesit hetimor me qëllim të përcaktimit nëse ishte kryer apo jo vepër penale dhe nëse ishte kryer vepër penale, cila vepër do të mund të ishte dhe kush mund të ishte/ishin i/të dyshuari/dyshuarit. Përfaqësuesi i ankuesve nuk iu ishte përgjigjur kërkesave të fundit që i ishin dërguar atyre nga ana e prokurorit vendor dhe informatat e dhëna nga ankuesit deri më tani dukeshin të kishin vlerë dëshmuese të kufizuar.

24. Në lidhje me pyetjet e Panelit sa i përket statusit të atëhershëm të rastit, ShM-ja ka theksuar se prokurori i EULEX-it ishte takuar me prokurorin vendor për të diskutuar rreth hapave që ishin ndërmarrë. Meqë prokurori vendor që fillimisht ishte caktuar për rastin në atë kohë ishte suspenduar, nën dyshimet për shkelje të detyrës, rasti i ishte caktuar një prokurori tjetër vendor. Ky prokuror vendor ka shprehur keqardhje për pamundësinë e ndërmarrjes së hapave që prej se i ishte caktuar rasti meqë ai ka pretenduar se ishte tejet i ngarkuar me hetime të rasteve më urgjente, ku të pandehurit ishin në paraburgim. Megjithatë prokurori vendor ka informuar prokurorin e EULEX-it për qëllimin e tij që të konsultohet me prokurorinë e shtetit me qëllim të marrjes së udhëzimeve për rastin dhe tha se do të vazhdonte më tej në bazë të rezultateve nga ai konsultim.
25. Megjithatë prokurori vendor ka theksuar se vepra penale që më së shumti kishte mundësi të dilte nga ky rast ishte ajo e "shkaktimit të dëmit të përgjithshëm", e cila ishte e dënueshme me nenin 365 të Kodit Penal të Kosovës (Ligji nr. 04/L-082). Në ato rrethana, periudha e parashkrimit e paraparë në nenin 106 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës do duhej të merrej parasysh, andaj ishte shumë e mundur që ajo vepër tani të ishte e parashkruar. Kjo nënkuptonte se kallëzimi penal do të duhej të hidhej poshtë.
26. ShM-ja ka theksuar se kryeprokurori i EULEX-it kishte siguruar se prokurori i EULEX-it që më parë kishte qenë i caktuar për rastin do të mund në çdo rast të vihej në dispozicion të prokurorit vendor në kapacitet të mentorimit dhe këshillimit, jashtë funksionit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë. Përveç kësaj, siç u theksua më sipër, palët kurdo mund të paraqesin ankesë të hollësishëm tek kryeprokurori i Shtetit dhe tek kryeprokurori i EULEX-it nëse konsiderohej se rrethanat kishin ndryshuar dhe se kushtet e parapara në nenin 7A të Ligjit për Juridiksionin të ishin përmbushur. ShM-ja gjithashtu ka thënë se kryeprokurori i EULEX-it e kishte dërguar vendimin e Panelit dhe analizën e vet të rastit (të kryeprokurorit) tek kryeprokurori i shtetit të Kosovës për shqyrtim nga ana e tij.
27. Më pas Sekretariati i Panelit i ka shkruar ShM-së më 12 korrik 2016 për ta informuar atë se Paneli kishte për qëllim të shqyrtonte më tej rastin dhe të nxirrte një vendim të dytë pasues. Në lidhje me atë, Paneli ka dëshiruar të dëgjonte prej ShM-së nëse kishte ndonjë informatë tjetër shtesë në dispozicion dhe në veçanti nëse procedura hetimore kishte shënuar progres. Paneli po ashtu ka pyetur ShM-në nëse prokurori i EULEX-it ishte përfshirë në kapacite të mentorimit dhe monitorimit. Paneli ka kërkuar përgjigje nga ShM-ja jo më vonë se deri me datën 19 gusht 2016.
28. ShM-ja ishte përgjigjur me 17 gusht 2016 për të thënë se rasti tani binte nën kompetencën ekskluzive të prokurorit vendor në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës dhe më tej se prokurorët e EULEX-it në fakt nuk ishin përfshirë në asnjë aktivitet formal të mentorimit dhe monitorimit. Megjithatë ShM-ja ka theksuar se udhëheqësi i ekipit të prokurorëve të EULEX-it në Mitrovicë ishte takuar me prokurorin e ri të caktuar vendor më 2 shkurt 2016 dhe prapë me 3 gusht 2016 me qëllim të përcaktimit nëse hetimet kishin shënuar ndonjë progres të mëtejshëm.
29. Gjatë takimit të datës 2 shkurt 2016, prokurori i EULEX-it ka informuar prokurorin vendor të ri rreth takimit që ishte mbajtur më parë me prokurorin kosovar, i cili kishte qenë i caktuar më parë për rastin dhe për hapat hetimor që ishin ndërmarrë.
30. Prokurori i EULEX-it po ashtu ka informuar prokurorin e ri të caktuar rreth vendimit dhe rekomandimeve të Panelit si dhe rreth dëshirës së tyre për të mësuar rreth ndonjë hapi hetimor që do të mund të ishte ndërmarrë. Prokurori i ri vendor ka shprehur keqardhjen për pamundësinë e ndërmarrjes së ndonjë hapi hetimor dhe ka thënë se ishte tejet i ngarkuar me raste të tjera më urgjente me të pandehur që ishin në paraburgim. Për më tepër, prokurori vendor në fjalë nuk ishte i përgatitur për takime të tjera pasuese për shkak të ngarkesës me punë dhe angazhimeve të tij.

31. Në takimin e radhës së mbajtur më 3 gusht 2016, prokurori vendor ka thënë se nuk kishte ndërmarrë asnjë hap tjetër hetimor që nga takimi paraprak i mbajtur më 2 shkurt 2016. Megjithatë ai ka theksuar se e kishte shqyrtuar rastin dhe kishte ardhur në përfundim se rasti do të mund të vazhdonte në dy drejtime të mundshme. Së pari, rasti do të mund të gjykohej nën akuzat për "shkaktim të rrezikut të përgjithshëm" dhe së dyti, rasti do të mund të gjykohej nën akuzat për "krim të organizuar", çka do të nënkuptonte se rasti do të binte nën kompetencën ekskluzive të kryeprokurorit të shtetit. Ai dukej se e favorizonte opsionin e parë, i cili do të shpinte në mbylljen e rastit në bazë të afatit të parashkrimit të paraparë me nenin 106 të Kodit të Procedurë Penale të Kosovës (Ligji nr. 04/L-082).
32. Prokurori i EULEX-it ka caktuar një takim pasues me prokurorin vendor për datën 10 gusht 2016, por se ishte anuluar prej prokurorit vendor me arsyen se duhej të merrte pjesë në detyra më urgjente.
33. ShM-ja ka theksuar si përfundim se për shkak të mungesës së progresit të kësaj lënde dhe mungesës së angazhimit të vërtetë nga ana e prokurorit vendor të caktuar për rastin, kryeprokurori i EULEX-it i kishte kërkuar Njësisë Këshilluese të EULEX-it për Çështje të Drejtësisë që ta monitoronin këtë lëndë zyrtarisht më 10 gusht 2016.

### III. VENDIMI I DYTË PASUES

34. Më 10 janar 2017, Paneli përsëri u kthye në këtë lëndë për të shqyrtuar masat e ndërmarrë nga Misioni në zbatimin e rekomandimeve të Panelit. Në vendimin e asaj date, Paneli ka marrë parasysh hapat shtesë të mëtejshëm të ndërmarrë nga ShM-ja për zbatimin e rekomandimeve të Panelit. Megjithatë, Paneli gjithashtu konsideroi se këto hapa "nuk kanë qenë të tilla që të siguronin se e drejta e ankuesve për një zgjidhje efektive është duke u mbrojtur në mënyrë efektive". Më tej vuri në dukje se kryeprokurori i EULEX-it ka ofruar garancinë e tij që prokurori i EULEX-it, i caktuar më parë në këtë lëndë, mund të jetë në dispozicion të prokurorit vendor në një kapacitet për mentorin dhe këshillim jashtë funksionit ekzekutiv të EULEX-it (Letra nga ShM-ja, 2 mars 2016). Paneli gjithashtu vëren se kryeprokurori i EULEX-it ka kërkuar nga Njësia Këshilluese e EULEX-it për Çështje të Drejtësisë që ta monitoronte lëndën zyrtarisht për shkak të mungesës së progresit dhe mungesës së angazhimit të vërtetë nga ana e prokurorit vendor me 10 gusht 2016 (letra nga ShM-ja, 17 gusht 2016).
35. Pas shqyrtimit të informatave të fundit që janë dhënë nga ShM-ja në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Paneli, Paneli ka bërë gjetjet dhe rekomandimet vijuese:

*"Deklaron se ShM-ja deri më tani nuk ka mundur t'i zbatojë më tej rekomandimet e dhëna nga Paneli, siç përshkruhet në Vendimin dhe të Gjeturat fillestare të Panelit të datës 22 prill 2015.*

*Deklaron se të drejtat e ankuesve për zgjidhje juridike efektive vazhdojnë të jenë të prekura negativisht nga mungesa e hetimeve efektive të qarta rreth lëndës.*

*E fton Misionin, përmes ShM-së, të kërkojë informata të rregullta nga autoritetet e Kosovës në lidhje me ecurinë e hetimeve, në veçanti me statusin e monitorimit zyrtar të rastit nga ana e prokurorit të EULEX-it.*

*E fton Misionin të vazhdojë të ndërlidhet me autoritetet përkatëse të Kosovës me qëllim të përcjelljes së ecurisë së rastit.*

*E fton ShM-në të informojë Panelin rreth ecurisë së hetimeve në fjalë deri më datën 28 shkurt 2017".*

36. Në përgjigje të kësaj çfarë u tha më sipër, me shkresën e datës 29 maj 2017, ShM-ja i ka shkruar Panelit dhe e ka informuar atë se në kundërshtim me indikacionet e mëparshme, lënda nuk ishte mbyllur, por ishte duke u hetuar nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë (Vushtrri).

#### **IV. VENDIMI I TRETË PASUES**

37. Më 27 mars 2019, Paneli ka lëshuar vendimin e tretë pasues. Në atë vendim, Paneli më tej vuri në dukje si në vijim.
38. Më 15 dhjetor 2017, Paneli përsëri i ka shkruar shefes së Misionit për të pyetur rreth zhvillimeve të reja në këtë lëndë.
39. ShM-ja është përgjigjur përmes një shkrese me datën 30 mars 2018. Në atë shkresë, ShM-ja ka treguar se Misioni kishte mbajtur disa takime me autoritetet përkatëse të policisë dhe prokurorisë për të kërkuar informata mbi ecurinë e hetimit. ShM-ja gjithashtu ka sqaruar se hetimi i asaj lënde ishte monitoruar që nga gushti i vitit 2016 nga Njësia Këshillëdhënëse për Çështjet e Drejtësisë në Divizionin për Përforcim. ShM-ja ka saktësuar se lënda ka mbetur aktive, por ka qenë në fazën paraprake hetimore dhe se kishte vazhduar të monitorohej nga Njësia Këshillëdhënëse për Çështje të Drejtësisë.
40. Përmes shkresës së datës 12 prill 2018, Paneli ka konfirmuar se ka pranuar letrën e fundit të ShM-së dhe ka ftuar atë të plotësonte përgjigjen e saj me informata rreth çfarëdo progresi të mëtejshëm të arritur në këtë lëndë.
41. ShM-ja ishte përgjigjur përmes një shkrese të datës 22 maj 2018 në të cilën ajo tregoi se "nuk ka pasur progres të mëtejshëm thelbësor që nga [letra] e datës 30 mars 2018". Ndërsa duke treguar për një numër takimesh që ishin mbajtur në lidhje me këtë rast, ShM-ja tregoi se situata 'nuk ka ndryshuar' që nga njoftimi i fundit i saj dhe se ende nuk ishte lëshuar ndonjë aktvendim mbi fillimin e hetimit. ShM-ja gjithashtu ka theksuar pikëpamjen e saj se 'është përgjegjësi e institucioneve të Kosovës për të kryer një hetim efektiv'. Së fundi, ShM-ja është angazhuar të vazhdojë të monitorojë zhvillimet në këtë rast brenda mundësive dhe aftësive të Misionit.
42. Përmes shkresës së datës 17 janar 2019, Paneli ka dërguar një kërkesë tjetër për njoftim në lidhje me këtë rast. Në veçanti, nga ShM-ja ishte kërkuar që të ofronte dëshmi në lidhje me sa vijon:
- a. Nëse Misioni ishte në dijeni për ndonjë zhvillim në këtë lëndë që nga njoftimi i fundit;
  - b. Nëse Misioni kishte ndërmarrë ndonjë hap apo masë shtesë në zbatimin e rekomandimeve të Panelit që nga ajo kohë;
  - c. Nëse, sipas njohurisë së Misionit, ishte ndërmarrë ndonjë hap nga autoritetet vendore për të vazhduar hetimin e kësaj lënde dhe posaçërisht nëse lënda ishte ende aktive apo e mbyllur?
  - d. Nëse vendimet e Panelit në lidhje me këtë lëndë iu janë komunikuar autoriteteve vendore së bashku me dosjen e lëndës;
  - e. Nëse është duke u zhvilluar ose planifikuar të ketë ndonjë përcjellje - në formë të monitorimit ose ndryshe - nga Misioni në lidhje me atë lëndë.

43. Më 20 shkurt 2019, ShM-ja iu është përgjigjur pyetjeve të Panelit dhe ka treguar si në vijim. ShM-ja ka treguar se Njësia për Monitorimin e Lëndëve ka kontaktuar prokurorin kompetent në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës dhe ishte njoftuar se lënda ishte ende në fazën paraprake të hetimit. ShM-ja gjithashtu ka vënë në dukje ndryshimin në natyrën e mandatit të Misionit dhe ka treguar se Misioni do të vazhdojë të monitorojë në mënyrë periodike atë lëndë. ShM-ja ka theksuar faktin se nën mandatin aktual, Misioni nuk është i autorizuar të këshillojë institucionet vendore në lidhje me lëndët individuale. Për më tepër ShM-ja ka parashtruar se sipas mandatit aktual, Misioni nuk është në gjendje të sigurojë që viktimat do të gëzojnë të drejtat e ankuesve për një zgjidhje efektive. Gjithashtu është vënë në pah se kryeprokurori shtetit të Kosovës ishte informuar për vendimin e Panelit dhe vendimin e PKDNj-së në lidhje me këtë lëndë.
44. Më 22 shkurt 2019, letra e ShM-së iu ishte dërguar përfaqësuesit të ankuesve për informim dhe në mënyrë që t'u ofrojë atyre një mundësi që të paraqitet ndonjë parashtrësë në përgjigje të letrës së ShM-së. Në të njëjtën ditë, më 22 shkurt 2019, përfaqësuesja e ankuesve ka konfirmuar pranimin e letrës dhe ka treguar se ajo do të ofronte ndonjë parashtrësë të mëtejshme jo më vonë se data 15 mars 2019.
45. Më 3 mars 2019, përfaqësuesja e ankuesve, i ka shkruar Panelit dhe iu ishte përgjigjur parashtrësave të ShM-së. Ajo ka treguar se përgjigja e ShM-së nuk ishte 'asgjë e re' dhe se përbëhej nga sugjerimi se a) nuk ishte përgjegjësia e Misionit dhe b) refuzoi të pranonte ose t'i përmbahej vendimeve të Panelit. Znj. Post gjithashtu e vë në dyshim vërtetësinë dhe besueshmërinë e pretendimit se aktualisht çështja është duke u hetuar nga autoritetet e Kosovës. Ajo gjithashtu fton Panelin që të merr në konsideratë urdhërimin e kompensimit për secilën familje.
46. Në bazë të kësaj, Paneli ka konstatuar se ankuesit në këtë rast ende nuk kanë qasje në ndonjë zgjidhje efektive juridike për t'iu vërtetuar të drejtat e tyre themelore dhe për të marrë ndihmë dhe dëmshpërblim adekuat për shkeljen e atyre të drejtave.
47. Paneli thekson faktin se autoritetet vendore janë duke u marrë më lëndën në mënyrë të duhur dhe aktualisht po e hetojnë atë. Paneli gjithashtu thekson angazhimin e Misionit për të monitoruar rregullisht rrjedhën e veprimit të autoriteteve në lidhje me hetimin e kësaj lënde. Paneli dëshiron që në mënyrë të qartë të nënvizojë nevojën që Misioni duhet t'ju bëjë të qartë autoritetet kompetente vendore faktin se ky rast duhet të hetohet në mënyrë të plotë dhe efektive, pasi kjo ka të bëjë me llojin më serioz të shkeljeve të të drejtave të njeriut.
48. Së fundi, në përgjigje të parashtrësave të përfaqësueses së ankuesve, Paneli thekson se nuk ka autorizim sipas instrumentit të tij statusor që të urdhërojë të ofrohet ndonjë ankuesi kompensim financiar (Raporti vjetor 2016 i PShDNj-së, faqet 2 dhe 48-50; *Zahiti kundër EULEX-it*, 2012-14, 11 nëntor 2014, në veçanti, paragrafi 16).

## V. VENDIMI I KATËRT PASUES

49. Më 11 dhjetor 2019, Paneli mori vendimin e tij të katërt përcjellës. Në atë vendim, Paneli nxori këto gjetje:
50. Më 12 shtator 2019, Paneli i ka shkruar shefit të Misionit me qëllim që të merrte informacion shtesë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Panelit në këtë rast dhe se cilat përpjekje ishin bërë për të korrigjuar shkeljet e të drejtave të identifikuara nga Paneli në këtë rast.



51. Më 31 tetor 2019, Misioni iu përgjigj Panelit dhe dha informacion në lidhje me hetimin e Panelit. Disa nga këto informacione i janë dhënë Panelit në mirëbesim. Duke marrë në konsideratë përmbajtjen e këtij informacioni, Paneli është i bindur që është në gjendje të ushtrijë funksionet e tij në mënyrë të drejtë dhe pa shkaktuar paragjykim ndaj ankuesve pavarësisht nga pamundësia e Panelit për t'ua zbuluar ato informacione ankuesve. Sidoqoftë, duke marrë parasysh rëndësinë e këtij informacioni, Paneli fton Misionin të konsiderojë shpërndarjen e këtij informacioni tek autoritetet përkatëse të BE-së me qëllim të adresimit të çështjeve të përmendura në të.
52. Duke marrë parasysh pyetjen e Panelit nëse Misioni është në dijeni për ndonjë zhvillim në hetimin e këtij rasti, Misioni tregoi se rasti është ende aktiv.

*“Por, për fat të keq, asnjë hap konkret nuk është ndërmarrë që nga letra e EULEX-it e datës 20 shkurt 2019 drejtuar Panelit. Asnjë vendim për fillimin e ndonjë hetimi nuk është nxjerrë”.*

53. Lidhur me pyetjen e Panelit nëse Misioni ka marrë ndonjë hap apo masë tjetër në zbatimin e rekomandimeve të Panelit që nga data 20 shkurt 2019, Misioni ka treguar se ka dorëzuar një kopje të “Vendimit të tretë për zbatimin e rekomandimeve të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut” të datës 27 mars 2019 dhe vendimet tjera të PShDNJ-së lidhur me këtë rast prokurorit të ngarkuar me rastin. Në atë rast, Misioni po ashtu ka pyetur prokurorin nëse ka pasur ndonjë zhvillim që nga shkurti i vitit 2019 dhe ishte informuar se nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim shtesë.
54. Duke marrë parasysh që ankuesve nuk iu është dhënë ende qasje në mjetin juridik për t'i realizuar të drejtat e tyre themelore, Paneli i ka bërë rekomandimet si në vijim:

*“Nënvizon rëndësinë që viktimat të kenë qasje në drejtësi dhe në një mjet efektiv juridik për të përmbushur të drejtat e tyre;*

*Për më tepër vëren se rasti ka qëndruar pezull para një numri të madh autoritetesh të njëpasnjëshme për dy dekada;*

*Fton Misionin që të vazhdojë të kryejë mandatin e tij në maksimum me qëllim që të sigurohet se të drejtat e ankuesve respektohen dhe garantoohen plotësisht dhe t'iu sigurojë një kopje të këtij vendimi autoriteteve vendore kompetente;*

*Fton Misionin të marrë në konsideratë shpërndarjen e përmbajtjes së informacionit konfidencial tek autoritetet përkatëse të BE-së;*

*Fton Misionin t'i shpërndaj kopjet e këtij vendimi tek organet përkatëse brenda Misionit dhe me bashkëbiseduesit përkatës jashtë tij;*

*Fton Misionin të bëjë një rishikim të plotë të mjeteve në dispozicion të Misionit për të korigjuar shkeljen e të drejtave të ankuesve në mënyrë efektive dhe t'i raportojë Panelit për masat që ai propozon t'i zbatoj për ta bërë këtë;*

*Fton Misionin t'i informojë dhe përfshijë ankuesit, në përputhje me rrethanat, në kryerjen e një shqyrtimi të tillë;*

*Fton Misionin të konsiderojë që t'i kontaktoj shteteve anëtare përmes Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm në lidhje me mundësinë e dëmshpërblimit ose kompensimit për shkeljen e të drejtave të ankuesve që i janë atribuar Misionit nga ana e Panelit”.*

## VI. VENDIMI PESTË PASUES

55. Ky vendim përbën një vendim të mëtutjeshëm dhe të pestë pasues në përputhje me rregullën 45 e *tutje* të Rregullores së punës së Panelit.
56. Më 18 dhjetor 2019, Paneli ka komunikuar vendimin ShM-së dhe ka kërkuar nga Misioni që të jepte përgjigje ndaj pyetjeve deri më 16 mars 2020.
57. Më 20 gusht 2021, Paneli i kishte shkruar sërish Misionit dhe kishte kërkuar informacione për zbatimin e rekomandimeve të vendimit të katërt pasues sa më shpejt që të ishte e mundur.
58. ShM-ja ishte përgjigjur me një letër të datës 1 dhjetor 2021 dhe kishte informuar Panelin se, pas vendimit të fundit, Misioni ka bërë hetime të mëtejshme me autoritetet përkatëse të prokurorisë dhe nuk ka përparim në hetimin, i cili mbetet i hapur. Për më tepër, ShM-ja kërkon nga Paneli që të mbyllë shqyrtimin e rastit.
59. Më 22 dhjetor 2021, letra e ShM-së iu ishte ofruar përfaqësuesit të ankuesve për informacion dhe në mënyrë që t'u jepej atyre një mundësi për të bërë ndonjë parashtresë në përgjigje të letrës së ShM-së.
60. Në ditën vijuese, më 23 dhjetor 2021, përfaqësuesi i ankuesve ishte përgjigjur se mjete juridik efektive ende nuk ishte zbatuar. Ajo ka sugjeruar se Misioni mund të kishte kontaktuar Ministrin e Drejtësisë dhe Ministrinë për Komunitete dhe Kthim lidhur me rastin. Ajo ka sugjeruar më tej që komisioni i sapoformuar për të vërtetën dhe pajtimin mund të informohej. Përkundrazi, sipas mendimit të saj, Misioni në thelb nuk ka reaguar ndaj asnjërës prej pyetjeve të Panelit.
61. Paneli, me letrën e datës 18 janar 2022, i ka ofruar ShM-së një kopje të letrës së ankuesve. ShM-ja nuk ka ofruar parashtresa të mëtejshme.
62. Në bazë të kësaj, Paneli ka konstatuar se ankuesit në këtë rast nuk kanë qasje në ndonjë zgjidhje efektive juridike për t'u vërtetuar të drejtat e tyre themelore dhe për të marrë ndihmë dhe dëmshpërblim adekuat për shkeljen e atyre të drejtave.
63. Paneli është i shqetësuar jo vetëm për faktin se ky rast ende nuk është duke u hetuar nga autoritetet vendore, por edhe nga dështimi i Misionit për të marrë parasysh ndonjë nga rekomandimet e Panelit të përcaktuara në vendimin e katërt pasues.
64. Paneli rithekson se obligimi i Misionit për të korrigjuar gabimet e shkaktuara nga shkelja e obligimeve të tij që i ka ndaj të drejtave të njeriut sipas ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut vazhdon dhe se Misioni nuk mund të përdorë faktin se mandati i tij ka ndryshuar, marrë parasysh që shkelja është gjetur të jetë pretekst për të mos ofruar ndonjë zgjidhje efektive juridike. Paneli pranon se hetimi tani i mbetet autoriteteve vendore mbi të cilat Paneli nuk ka kompetencë për të vlerësuar përputhshmërinë e sjelljes së tyre me standardet përkatëse të të drejtave të njeriut. Megjithatë, dështimi i vazhdueshëm për të siguruar një lloj forme të hetimit dhe mjeteve juridike për ankuesit domosdoshmërisht përfshinë shkeljen e vazhdueshme të të drejtave të tyre nga Misioni.
65. Paneli është gjithashtu i alarmuar nga fakti se ftesa e tij drejtuar Misionit për të kryer një shqyrtim të plotë të mjeteve në dispozicion për të korrigjuar shkeljen, ftesën për të shpërndarë esencën e rastit tek autoritetet përkatëse të BE-së dhe që edhe më tutje të kontaktojë EEAS-në për të shqyrtuar mundësinë e ofrimit të një mjeti juridik, ishin injoruar plotësisht nga ShM-ja.

66. Për arsyet e lartpërmendura, Paneli nuk është në pozitë të mbyllë shqyrtimin e rastit, por është i detyruar të përsërisë rekomandimet e vendimit të katërt pasues në tërësi.

## **PRANDAJ, PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI**

**Konstaton** se ankuesve ende duhet t'u sigurohet një mjet juridik dhe dëmshpërblim adekuat për shkeljen e të drejtave të tyre;

**Nënvizon** rëndësinë që viktimat të kenë qasje në drejtësi dhe në një mjet efektiv juridik për të përmbushur të drejtat e tyre;

**Për më tepër vëren se** lënda ka qëndruar e pakryer përpara një numri të madh autoritetesh të njëpasnjëshme për dy dekada;

**Fton** Misionin të vazhdojë ta kryejë mandatin e tij në maksimum, me qëllim që të sigurojë që të drejtat e ankuesve të respektohen dhe garantohen plotësisht dhe të ofroj një kopje të këtij vendimi tek autoritetet kompetente vendore;

**Fton** Misionin të marrë në konsideratë shpërndarjen e përmbajtjes së informacionit konfidencial tek autoritetet përkatëse të BE-së;

**Fton** Misionin t'i shpërndaj kopjet e këtij vendimi tek organet përkatëse brenda Misionit dhe tek bashkëbiseduesit përkatës jashtë tij;

**Fton** Misionin të bëjë një rishikim të plotë të mjeteve në dispozicion të Misionit për të korrigjuar shkeljen e të drejtave të ankuesve në mënyrë efektive dhe t'i raportojë Panelit në lidhje me masat që ai propozon t'i zbatoj për ta bërë këtë;

**Fton** Misionin t'i informojë dhe përfshijë ankuesit, siç duhet, në kryerjen e një shqyrtimi të tillë;

**Fton** Misionin të konsiderojë që t'i kontaktoj shteteve anëtare përmes Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm në lidhje me mundësinë për dëmshpërblim ose kompensim për shkeljen e të drejtave të ankuesve që i janë atribuar Misionit nga ana e Panelit;

**E mban këtë lëndë të hapur** për përcjellje të mundshme; dhe

**Fton** Misionin të ofroj përgjigje në lidhje me pyetjet e mësipërme jo më vonë se data 15 nëntor 2022.

Për Panelin,

Snježana BOKULIĆ  
Ushtruese e detyrës së kryesueses së Panelit

Petko PETKOV  
Anëtar

